VENDIM
Nr. 795, datë 9.11.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI DHE RIKONSTRUKSIONI I BULEVARDIT "FAN NOLI"", NË BASHKINË E KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi dhe rikonstruksioni i bulevardit "Fan Noli"", në Bashkinë e Korçës.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Korçë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë "tokë truall", me sipërfaqe 82,24 (tetëdhjetë e dy presje njëzet e katër) m², me vlerë të përgjithshme të shpronësimit 702 083 (shtatëqind e dy mijë e tetëdhjetë e tre) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 702 083 (shtatëqind e dy mijë e tetëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet buxheti i Bashkisë Korçë.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Korçë.
6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë e Korçës, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
8. Regjistrimi i ri i pasurisë "tokë truall", prej 82,24 (tetëdhjetë e dy presje njëzet e katër) m², për projektin "Zgjerimi dhe rikonstruksioni i bulevardit "Fan Noli"", të bëhet në favor të Bashkisë Korçë.
9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "ZGJERIM DHE RIKONSTRUKSION I BULEVARDIT "FAN NOLI", NË BASHKINË E KORÇËS

Nr. rendor	Emër atësi mbiemër	ZK	Nr. pasurie	Lloji i pas.	Truall (m²) ZVRPP	Sip. e cila shpronësohet	Çmimi lekë/ m²	Vlera totale e shpronësimit	Vërtetim nga ZRPPP-ja
1	Riza Kollel Kalemi Pranvera Veliu Aferdita Veliu Gazmend Veliu	8564	1/39	T+ND	534.0 m² – 179.8 m²	82.24	8537	702 083	Konfirmim nga ZRPPP-ja
	Totali							**702 083**	